



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 714/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, Ferizaj, kundër debitorit “A-C...” Sh.p.k., me seli në Fushë Kosovë, rruga “....., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.378/2021, të datës 28.05.2021, të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “A-C...” Sh.p.k. dhe ANULOHET pjesërisht urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.378/2021, i datës 28.05.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Besnik H. Aliu, për pjesën e kamatës ligjore prej datës 05.04.2021, e deri në pagesën përfundimtare.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.378/2021, të datës 28.05.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 4,200.00 € (katër mijë e dyqind euro).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, Ferizaj, ndaj debitorit “A-C...” Sh.p.k, sipas urdhrit përmbartimor P.nr.378/2021, të datës 28.05.2021, të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, për pjesën e kamatës ligjore prej datës 05.04.2021, e deri në pagesën përfundimtare.

A r s y e t i m

Kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit “A-C...” Sh.p.k., për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbarues Vendimi Nr.14/2021, i datës 05.02.2021, i formës së prerë me datë 05.04.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 05.04.2021, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës t’ia paguaj shumën prej 4,200.00 €, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në xhirollogarinë Nr.....

Përmbaruesi Privat Besnik H. Aliu, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës, me datë 28.05.2021, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.378/2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.14/2021, të datës 05.02.2021. Kreditori në propozimin për përmbarim të datës 28.05.2021, ka kërkuar që të detyrohet debitori “A-C...” Sh.p.k., që në emër të gjobës kreditorit t’ia paguaj shumën prej 4,200.00 €, me kamatë ligjore duke filluar nga data 05.04.2021, e deri në pagesën përfundimtare, me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare ose sekuestrimin e sendeve të luajtshme gjerë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Debitori “A-C...” Sh.p.k., brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, në të cilin ka deklaruar se urdhri për përmbarim përbën shkelje të nenit 71 par.1, pika 1.2 dhe 1.4, ngase debitori edhe me ankesë e ka sqaruar se vendimi është marrë pa vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, meqenëse debitori ka treguar se ka qenë faji i investitorit, pasi që nuk ka qenë i kujdesshëm për punën që ka kryer. Ka shtuar se dokumenti në të cilin bazohet kreditori nuk ka efekt, pasi që debitori është i gatshëm të dëshmojë se nuk ka qenë përgjegjësia e tij. Ka theksuar se urdhri për përmbarim tejkalon kërkesën e kreditorit me rastin e lejimit të kamatës ligjore pasi që në dokumentin përmbarimor nuk është kontraktuar kamata. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar dhe të refuzohet urdhri përmbarimor si i pabazuar.

Kreditori me përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar për shkak se propozimi për përmbarim është paraqitur pasi që debitori nuk e ka përmbushur detyrimin për pagesën e gjobës të shqiptuar me vendimin e Inspektoratit të Punës. Ka shtuar se shkresat lidhur me rastin konkret janë nxjerrë në harmoni të plotë me ligjet në fuqi

si dhe gjendjen faktike e kanë verifikuar në mënyrë të drejtë dhe është vërtetuar edhe nga Organi i Shkallës së Dytë, Inspektorati i Punës në Prishtinë me Vendimin Nr.699/2021. Tutje ka shtuar se mbetet pranë propozimit të dhënë duke kërkuar nga gjykata që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbartimor Vendimin Nr.14/2021, të datës 05.02.2021, në bazë të të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimi Nr.14/2021, i datës 05.02.2021, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr.14/2021, i datës 05.02.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se:

*“Vërtetimin për përmbaueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase Vendimi Nr.14/2021, të datës 05.02.2021, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 05.04.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 05.04.2021.*

Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përmbaueshmëri P.nr.378/2021, të datës 28.05.2021, të Përmbauesit Privat Besnik H. Aliu, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbaueshmëri, mirëpo konstatoi se me dokumentin përmbaueshmëri sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbaueshmëri, debitori është obliguar që në emër të gjobës t’ia paguaj kreditorit shumën prej 4,200.00 €, mirëpo jo edhe kamatën ligjore prej datës 05.04.2021, e deri në pagesën përfundimtare dhe si i tillë urdhri përmbaueshmëri nuk është në përputhje me dokumentin përmbaueshmëri, andaj gjykata të njëjtin e shfuqizoi pjesërisht vetëm sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaueshmëri dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë  
Departamenti për Çështje Ekonomike  
KPPP.nr.714/22, datë 30.09.2022

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.